Njesia Org.
Org.Jedinica
Org Unit 02
Nr.i faqeve
Br.strranica
No.pages -5-
Nr. Prot.
Broj
Prot. 05-4792
Data
Datum
Date 08 / 07 / 26
Prishtinë / a

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë/Ministry of Health/Ministarstvo Zdravstva

PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE/PSO

EMRI I PSO: DIAGNOSTIKIMI MIKROSKOPIK I LEISHMANIAS, PIKA E DENDUR (ITG03/V1.0)

PËRMBAJTJA: DOKUMENTI PËRFSHIN HAPAT KRYESORË PËR PERGATITJEN E MOSTRAVE, APLIKIMIN E METODËS DHE INTERPRETIMIN E REZULTATEVE PËR DIAGNOSTIKIMIN MIKROSKOPIK TË LEISHMANIAS PIKA E DENDUR, DUKE SIGURUAR QË TESTIMI TË KRYHET NË MËNYRË TË SAKTË DHE TË STANDARDIZUAR.

VERSIONI: 1.0.
DATA E APROVIMIT: 07.07.2026
AUTOR: MSH/IKSHPK
NR. I HAPAVE: V
NR. I NËNHAPAVE: 27

APROVUAR: Jahë Gecaj
U.D. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Shëndetësisë

V.V

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - MINISTRIA E SHËNDETËSISË - MINISTARSTVO ZDRAVLJA - REPUBLIC OF KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA - MINISTRY OF HAELTH
Prishtinë / a

QËLLIMI	QËLLIMI I KËSAJ PSO ËSHTË TË SIGUROJË NJË QASJE TË STANDARDIZUAR PËR PROCESET PËR PERGATITJEN E MOSTRAVE, APLIKIMIN E METODËS DHE INTERPRETIMIN E REZULTATEVE PËR DIAGNOSTIKIMIN MIKROSKOPIK TË LEISHMANIAS PIKA E DENDUR, PROCEDURA E PËRSHKRUAR DUHET TË ZBATOHET NGA GJITHË PERSONELI LABORATORIK.
NDËRLIDHJA ME AKTET	• LIGJI NR. 08/L-200 PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E SËMUNDJEVE NGJITËSE;, • PLANI STRATEGJIK KOMBËTAR PËR LABORATORE 2024-2030; • DORACAKU PËR MENAXHIMIN E CILËSISË NË LABORATORË.
LISTA E SHKURTESAVE	• PSO - PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE; • PPM - PAJISJET PERSONALE MBROJTËSE; • ITG- INFEKSIONET E TRAKTIT GASTROINTESTINAL.

PROCEDURA

Nr.	HAPI	NËN-HAPAT
[I]	Zbatimi i masave për menaxhim të mostrave	1. Mostra merret nga infermieri në klinikë ose stafi infermieror në zyrën e pranimit; 2. Etiketimi i menjëhershëm me emrin ose kodin e pacientit, datën dhe orën e marrjes; 3. Verifikimi i përputhshmërisë së të dhënave të pacientit me formularin e kërkesës; 4. Mostra transportohet nga laboranti në zyrën e pranimit deri në laboratorin e Infeksioneve të Traktit Gastrointestinal; 5. Rezultati analizohet nga laboranti dhe mjeku përkatës; 6. Rezultati aprovohet nga mjeku përgjegjës; 7. Laboranti kryen pranimin dhe refuzimin e mostrës duke i respektuar kriteret e pranimit të mostrës në bazë të Doracakut për Cilësinë e punës në laborator;
[II]	Pajisjet dhe materialet e nevojshme për testim	1. Pajisjet dhe materialet që janë të nevojshme për testim: a. Epruvet me antikoagulat me EDTA; b. Lamë mikroskopike e pastër; c. Xhama mbulues mikroskopik; d. Ore (kohëmatës); e. Kiti per ngjyrosje me Giemsa ose ngjyrosja e Wright; f. Mikroskop me objektiv (10x, 40x, 100x); g. Vaj kedri; h. Dorëza Nitrile një përdorimëshe S,M,L; i. Qese Biohazard dhe laps-ngjyrë e përhershme; majë e dyfishtë; j. Pajisjet Personale Mbrojtëse (PPM); k. Kontejner i mbetjeve të rrezikut biologjik;
[III]	Veprimet e marrjes, përgatitja e pacientit dhe transportit të mostrës	1. Përgatitja e pacientit: a. Shpjegohet qëllimi i marrjes së mostrës dhe procedura, për të reduktuar ankthin dhe lëvizjet; b. Pacienti duhet të jetë i qetë dhe në pozicion që lejon akses të lehtë në zonën e marrjes së gjakut; c. Zona e marrjes së mostrës duhet të pastrohet me solucion antiseptik (p.sh. alkool 70%) dhe të thahet; 2. Marrja e mostrës për pikën e dendur: a. Gjak venoz (në epruveta me EDTA); b. Aspirat nga indet; c. Aspirat nga nyja limfatike; d. Aspirat nga palca e kockës; e. Lezion kutan;

		3. Transporti dhe ruajtja: a. Lamët me pika të dendura ruhen të mbuluara ose në qese të papërshkueshme nga lëngjet për të shmangur kontaminimin; b. Evitoni shtypjen ose dëmtimin e mostrës; c. Transporti të kryhet në enë ose ambalazh të përshtatshëm për mostra biologjike; d. Transport në temperaturë ambienti, larg dritës direkte dhe lagështisë; e. Nëse transporti zgjat, mund të përdoret frigorifer i kontrolluar (2–8°C) për materialet më të ndjeshme;
[IV]	Veprimet laboratorike të testimit të mostrës	1. Bëhen dy përgatitje për një mostër; 2. Merrni një pikë të vogël gjaku ose aspirati; 3. Vendoseni në lamë qelqi; 4. Shpërndajeni në formë pikë të dendur (thick smear), pa e holluar shumë; 5. Lëreni të thahet në ajër plotësisht; 6. Fiksoni lyerjen e gjakut duke e zhytur në metanol për 10-15 minuta; 7. Preparati ngjyroset, për ngjyrosje përdoret Giemsa; 8. Respektohet koha e ngjyrosjes dhe përqendrimi i rekomanduar i reagjentit; 9. Fiksoni preparatin me metanol 5-7 minuta; 10. Lamela shpërlahet me kujdes dhe lihet të thahet; 11. Ekzaminohet preparati me mikroskop optik; 12. Fillimisht vlerësohet cilësia e preparatit me zmadhim të ulët; 13. Më pas ekzaminohet me objektivin 100× me vaj zhytës; 14. Vëzhgohen fusha të shumta mikroskopike për praninë e formave amastigote të Leishmania spp;
[V]	Veprimet laboratorike të raportimit të rezultatit	1. Mikrobiologu ekzaminon preparatin mikroskopik. 2. Raportimi i rezultatit: a. Rezultat pozitiv: Ekzaminim mikroskopik: Identifikohen amastigotet (trupat Leishman-Donovan), të cilat paraqiten si trupa të vegjël ovalë me bërthamë dhe kinetoplast karakteristik sipas figurës 1 të shtojca 1). b. Rezultat negativ: Nuk vërehen forma amastigote pas ekzaminimit të fushave të mjaftueshme mikroskopike.

Shtojca 1.



Figura 1. Cikli jetësor dhe format e Leishmania.